



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Për: Z. Hekuran Murati, Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Kopje: Z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës

Nga: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Ehat Miftaraj

Lënda: KËRKESË PËR NXJERRJEN E NJË AKTI JURIDIK PËR ZBATIMIN E LIGJEVE

I nderuar Ministër,

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është Organizatë Jo-Qeveritare, që në kuadër të fushëveprimtarisë së vet vepron në mbrojtje të interesave publike.

Në kontekst të kësaj, IKD ka analizuar situatën e qytetarëve të vendit, pensionistëve, të cilëve përkundër punës disavjeçare dhe arritjes së moshës së pensionimit, **është duke iu mohuar e drejta në pensionit bazik**, si rezultat i keqkuptimit dhe keqinterpretimit të ligjit nga ana e Departamenteve të Pensioneve të MFPT-së. **Sipas ligjit dhe vendimeve të gjykatave të rregullta, përfshirë vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës**, vendime këto të formës së prerë secilit qytetar të Republikës së Kosovës, i njihet e drejta për pension bazik dhe përfitimin e të drejtave dhe beneficioneve të përcaktuara me Ligjin për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre.

Edhe përkundër këtij fakti, fatkeqësisht, Departamentet e Pensioneve në MFPT po ua mohojnë të gjithë qytetarëve që Ligji ua njeh këtë drejtë dhe që lidhur me këtë çështje është ndërtuar edhe praktika gjyqësore. Kjo po bëhet me arsyetimin se nuk u takon të marrin më shumë sesa një pension.

Për këtë çështje, IKD në mënyrë që të ngritët vetëdija publike e zyrtarëve publik në departamentet e pensioneve të MFPT-së lidhur me ligjin e aplikueshëm dhe vendimet gjyqësore që kanë vendosur në raste të njëjta, ka publikuar edhe materiale promovuese që e tregojnë se përfituesit e të drejtave dhe beneficioneve të përcaktuara me Ligjin për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre, kanë edhe të drejtën në pension bazik. **Pra, e kanë të drejtën në dy skema pensionale – atë të moshës, si dhe atë që rrjedh nga ligji për kategoritë e dala nga lufta.**

Përkundër kësaj, Departamentet e Pensioneve në MFPT po vazhdojnë me mohimin e kësaj të drejte dhe me mos zbatimin e ligjit, duke iu refuzuar kërkesat e qytetarëve për realizimin e të drejtës siç u takon.

Lidhur me këtë situatë, vetëm brenda dy muajve të fundit IKD, përmes Qendrës për Ndihmë Juridike falas ka pranuar mbi 500 kërkesa nga qytetarët e Republikës së Kosovës, si nga komuniteti shqiptar, ashtu edhe nga komunitetet jo shumicë, prej të cilave deri më tani janë përgatitur rreth 200 padi, të cilat në bazë të praktikës gjyqësore dhe kornizës ligjore, nuk pritet të vendosen ndryshe, përveç se në favor të qytetarëve të vendit, bazuar kështu në legjislacionin pozitiv dhe vendimet e gjykatave të rregullta që e trajtojnë këtë fushë.

Qasja e Ministrisë që Ju e udhëhiqni, ka krijuar një situatë të pakëndshme, ku me mijëra qytetarë të Kosovës, të moshave që arrijnë edhe 92-vjeçarë, po detyrohen të enden zyra të Departamenteve të Pensioneve, po detyrohen të vijnë nga rajone të ndryshme, të thella të vendit, duke krijuar shpenzime të panevojshme, vetëm e vetëm për të kërkuar realizimin e një të drejte që u takon.

Për më tepër, Ju informojmë se nuk është hera e parë në Republikën e Kosovës, që si rezultat i mos veprimit të pushtetit ekzekutiv dhe institucioneve ligj-zbatuese, si në nivel lokal ashtu edhe qendror, të ndikohet në rritjen e lëndëve në gjykata të rregullta. Me këtë rast, jua kujtojmë këtu rastin e kontratës kolektive, e cila vazhdon të ndikojë në rritjen e numrit të lëndëve në gjykata me dhjetëra-mijëra raste dhe me ngarkim të panevojshëm të buxhetit të shtetit me dhjetëra-miliona Euro. E njëjta situatë po përsëritet edhe me të drejtën e qytetarëve për të drejtën në pension bazik.

Për informimin tuaj për çdo padi të fituar në Gjykatë, Ministria përveç se do të jetë e obliguar të kompensojë pensionistët për të drejtat e tyre për periudhën në vijim, do të obligohet të paguajë edhe kompensimin në mënyrë retroaktive, shpenzimet procedurale lidhur me lëndët në fjalë, ku përfshihen avokatët për shërbimet e tyre, përfshirë këtu edhe shpenzimet gjyqësore. Ndërsa, duhet ditur se për çdo rast do duhet të hapet shqyrtim gjyqësor, të dërgohen ftesat për seanca gjyqësore, gjë që, krahas të tjerave, krijon edhe shpenzime të udhëtimit për pensionistët për të udhëtuar në Prishtinë nga çdo cep i Kosovës vetëm sa për të marrë pjesë në seancat gjyqësore në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

I nderuar Ministër,

Në dritën e gjithë këtyre argumenteve, IKD përmes kësaj parashtrese, ju kërkon që në përputhje me mandatin dhe obligimet e juaja si Ministër, të nxirrni një akt juridik për zbatimin e ligjeve.

Jua rikujtojmë edhe një herë se mënyra e vendosjes nga ana e Departamenteve të Pensioneve në MFPT përbën interpretim tërësisht të gabuar të ligjit, duke u referuar në nenin 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, por duke mos marrë fare për bazë faktin se Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre është ligj i veçantë në raport me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky ligj i veçantë (lex specialis),

në nenin 23, par. 2, përcakton se *“shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji.”* Madje, me asnjë dispozitë të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili është ligj i mëvonshëm, por as me ndonjë akt apo ligj tjetër, nuk është shfuqizuar ky nen i cituar më lart (neni 23).

Rrjedhimisht, meqenëse Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre, është ligj special në raport me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është e qartë se të gjithë shfrytëzuesit e pensionit bazë i gëzojnë edhe të drejtat nga Ligji për statusin dhe të drejtat e kategorive të dala nga lufta. Si përkufizim, në Ligjin për Fondet Pensionale nr. 04/L-101 të Kosovës, *“pensioni bazë” përcaktohet si një pension që Administrata Pensionale ua paguan të gjithë banorëve të përhershëm të Kosovës që kanë arritur moshën e pensionimit.* Në nenin 3 të këtij ligji, përcaktohet se *çdo person që është banor i përhershëm i Republikës së Kosovës dhe që arritur moshën e pensionimit ka të drejtë të merr pension bazë.* Kjo do të thotë se të gjithë ata që arrijnë moshën e pensionimit, e kanë të drejtën që të gëzojnë të dy pensionet.

Në anën tjetër, tashmë kemi edhe praktikë gjyqësore të vërtetuar deri në Gjykatë Supreme, se e drejta për pension bazë nuk mund t’i mohohet askujt. Aktgjykimet e gjykatave të Kosovës, të vërtetuara deri në Gjykatën Supreme, Ligjin për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre, e njeh si ligj të veçantë në raport me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Krahas kësaj, ajo që ndër të tjera thuhet në aktgjykim të Gjykatës Supreme është që e drejta e fituar me punë duhet të konsiderohet prioritet, më e favorshme dhe si e drejtë themelore e njeriut, andaj dhe askush nuk duhet të privohet nga kjo e drejtë, apo në raste të tjera personi i cili e arrin moshën e pensionimit si kontributpagues në bazë të punësimit.

Ndërsa, sa i përket pensionit të cilin qytetarët e gëzojnë si pension të kategorive të dala nga lufta, është e drejtë e cila i takon sa i përket kontributit të tyre ose të anëtarëve të ngushtë të familjes në luftën e fundit në Kosovë, ndërsa pensioni bazë është e drejtë që i takon në momentin e arritjes së moshës së pensionimit. Njëkohësisht edhe praktika e GJEDNJ-së, përcakton se *ushtrimi i të drejtës në pension bazë paraqet ushtrim të së drejtës në pronë, në bazë të nenit 1, Protokoli 1 i KEDNJ-së, i cili në paragrafin 1 përcakton se “çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”*

I nderuar Ministër,

Situata është shumë e qartë. Të gjithë banorët e përhershëm të Kosovës që kanë arritur moshën e pensionimit, e kanë të drejtën në pension bazë. Njëkohësisht të gjithë ata qytetarë që i kanë plotësuar kriteret për të qenë përfitues sipas kategorive të përcaktuara me Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës

seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre, e kanë të drejtën në pension nga kategoria së cilës i përkasin. Korniza ligjore pozitive të njëjtëve u njeh të drejtën e përfitimit të pensionit nga të dy këto skema dhe një gjë e tillë tashmë është vërtetuar edhe me aktgjykimet e formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë, asaj të Apelit, e të cilat vendime janë konfirmuar po ashtu nga Gjykata Supreme.

Përkundër kësaj, vendimet që janë nxjerrë dhe që po vazhdojnë të nxirren nga ana e Departamenteve të Pensioneve në MFPT, vazhdojnë të bëjnë interpretim tërësisht të gabuar të ligjit. Përkitazi me këtë, neni 11 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, parasheh *Kompetencat e ministrave*, ndërsa neni 1, pika 1.5 e tij, shprehimisht ka përcaktuar se Ministri, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij merr vendime dhe nxjerr akte të tjera juridike nga fushëveprimi i ministrisë, të nevojshme për zbatimin e ligjeve. Andaj, në përputhje me mandatin dhe obligimet e juaja si Ministër, IKD kërkon që të nxirrni një akt juridik për zbatimin e ligjeve.

I nderuar Ministër,

Ne Ju falënderojmë për kohën tuaj në leximin dhe kuptimin e kësaj shkresë të gjatë. Sidoqoftë, kërkojmë mirëkuptimin tuaj meqë kjo shkresë ndërlidhet me respektimin e dinjitetit të grupit më të marginalizuar në shoqërinë tonë – pensionistët. Në dritë të kësaj, më lejoni të Ju ri-kujtoj se Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, ndër të tjera ka edhe këtë deklaratë: ***“Vizioni jonë është rritja e mirëqenies për të gjithë qytetarët, pa dallim. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet mbështetjes së grupeve të cenuara dhe ristrukturimit të skemave sociale dhe pensionale, me qëllim të uljes së varfërisë dhe rritjes së aktivitetit në tregun e punës.”***

Në këtë drejtim, IKD kërkon nga ana juaj që në cilësinë e Ministrit të ushtroni kompetencat dhe përgjegjësitë tuaja dhe pa vonesë të ktheni dhe zbatoni ligjshmërinë përmes nxjerrjes së një akti juridik, përmes së cilit obligoni Departamentet e Pensioneve të bëjnë zbatimin e duhur të ligjeve të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të shmangin interpretimin e gabuar që po i bëhet legjislacionit aktual. Kësisoj, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët e kanë arritur moshën e pensionimit dhe që po ashtu kanë plotësuar kriteret për përfitimin e beneficioneve nga ligji për kategoritë e dala nga lufta, të realizojnë të drejtat e tyre në dy skema pensionale njëkohësisht – atë të moshës, si dhe atë që rrjedh nga Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre. Nxjerrja e aktit juridik do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë dhe do të ruante dhe respektonte dinjitetin e pensionistëve në Kosovë.

Prishtinë,

23 shkurt, 2024

Parashtruesi i kërkesës,

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD),
përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv,
Ehat Miftaraj

